

**Bashkërisht për jetë me dinjitet për të gjithë!**

**Të drejtat sindikaliste**

**E drejta e qasjes në kantiere!**

**2**

**Shkrim ekspertësh**

**Rasti ekzemplar i Flurim Thaqit**

**3**

**Manifestim ditor dhe ekspozita**

**Si jetonin sezionerët në Zvicër?!**

**4**

Nr. 6 | nëntor 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Iniciativa Ecopop**

## Të luftojmë së bashku kundër Ecopop-it!



Manifestimi në fjalë si shenjë kundër iniciativave që bëjnë fajtor migrantët për problemet vendore

**Më 30 nëntor do të votohet mbi iniciativën popullore «Stop mbipopullimit – Për sigurimin e mjeteve natyrore të jetesës». Edhe pse të gjitha partitë janë deklaruar kundër saj, iniciativa mbetet e rrezikshme, pasi ajo tematizon halle të ndryshme të shumë njerëzve. Ne duhet të kundërshtojmë këtë politik të fajësimit të migrantëve dhe të luftojmë për një Zvicër të hapur dhe solidare**

Shoqata «Ecopop» përmes iniciativës popullore «Stop mbipopullimit – Për sigurimin e mjeteve natyrore të jetesës», kërkon që popullata e përhershme e Zvicrës nuk guxon të rritet për shkak të migrimit më shumë se 0,2% dhe që së paku 10% e mjeteve shtetërore për ndihmë zhvillimore vendeve të varfra të përdoren për «planifikim familjar vullnetar».

**Migracioni nuk është problem**

Iniciativa Ecopop don që problemet e mjedisit ti zgjidh përmes kufizimit

radikal të migrimit. Ajo bënë migrantët fajtor kujdestar për problemet siç janë trenat e stërmbushur me njerëz, natyrën e betonuar dhe në përgjithësi mbingarkesat mjedisore. Edhe pse përfaqësuesit e iniciativës e mohojnë, ata bëhen bashkëpunëtor të partive dhe rrymave populiste, të cilat ka vite që predikojnë: se migracioni është i keq, se Zvicra duhet të «drejtohet» më fuqishëm dhe që në vend duhet lejuar të vijnë vetëm ata, të cilët janë me të vërtetë të «përdorshëm». Iniciativa, deshi s'deshi, diskriminon migrantet e migrantët.

**Ecopop paraqet sulm mbi punëmarrësit**

Ecopop-i do të qojë në përkeqësimin e kushteve të jetës dhe të punës për të gjithë, pasi punëdhënësit për shkak të kufizimit të migracionit do të jenë të detyruar të angazhojnë persona me leje të shkurtuar qëndrimi. Secili që ka kushte të përkeqësuar qëndrimi dhe frikë se do të humbë punën dhe lejen e qëndrimit, u nënshtrohet më lehtë presioneve të punëdhënëseve të paskrupullt. Kështu që herët a vonë këtij presioni do ti nënshtrohen edhe kushtet e punës dhe pagat parasë gjithash të të gjithë punëmarrësve në Zvicër. Në vend se më shumë mbrojtje për pagat tona dhe kushtet e punës, Ecopop qon tek përkeqësimi i kushteve të punës.

Pos tjerash Ecopop izolon Zvicrën edhe më shumë, pasi nuk është në përputhje me Marrëveshjet bilaterale. Pa bilaterale zhduket edhe qarkullimi i lirë i njerëzve, i cili ka ndihmuar realizimin e më shumë të drejtave të një pjese të migrantëve.

**S'është zgjidhje**

Iniciative pos tjerash nuk zgjidh as problemet mjedisore, pasi që jo «shumë» njerëz janë problemi, por që disa nga ta, posaçërisht të pasurit, jetojnë përtej mundësive të tyre dhe

konsumojnë së tepërmi nga burimet tona. Iniciativa mënjanon nga problemet e vërteta: në kurriz të të varfërve jeton një numër i vogël njerëzish, të cilët shkaktojnë shumë harxhime. Edhe kërkesa e njëanshme për «planifikim familjar vullnetar» është mjet i rrejshëm për luftimin e varfërisë. Gratë kanë nevojë për më shumë arsimim dhe për një pozitë më të mirë në shoqëri, me çka automatikisht qon në më pak lindje fëmijësh.

**Unia lufton për një JO!**

Ne duhet të angazhohemi fuqishëm për të hedhur poshtë dhe qartazi iniciativën në fjalë. Andaj Unia zhvillon një kampanjë kundër kësaj iniciative. Posaçërisht në këtë nëntor dhe paraprakisht

ht edhe në tetor ne ishim prezent me aksione shpërndarëse në rrugë dhe para ndërmarrjeve. Më 1 nëntor ne ishim në manifestim në sheshin federal dhe i kemi thënë qartazi JO Ecopop-it. Vetëm të bashkërisht ne mund të pengojmë që të kufizohen të drejtat e migrantëve dhe të të gjithë punëmarrësve. Me apo pa të drejtë vote, ne të gjithë mund të kontribuojmë që të luftojmë diskriminimin dhe përjashtimin. Për një Zvicër të hapur dhe solidare – voto me një JO Ecopop-in!



**NEIN ZU ECOPOP**

**Editorial**



**Jo ECOPOP-it**

Populli zviceran është i ftuar që më 30 nëntor edhe një herë tjetër të votojë për një iniciativë ksenofobe: Kësaj radhe është iniciativa Ecopop, e cila migrimin në Zvicër donë ta kufizoj në mënyrë drastike. Kjo është një iniciativë e rrezikshme, pasi e fshehtë natyrën e vet thellësisht ksenofobe, duke kapur një temë që hasë në simpati në pjesën më të madhe të popullsi: mbrojtja e ambientit.

Ajo është e rrezikshme, pasi është egoiste dhe pasi që përsëri migrantet e migrantët i paraqet si gjoja fajtor për problemet e vendit dhe nuk i identifikon fajtorët e vërtetë: sistemin ekonomik dhe shoqërinë zvicerane.

Ajo është e rrezikshme, pasi është jo humane, me qëllim që të kufizon migracionin e përhershëm dhe afatgjatë, ndërsa në të njëjtën kohë liberalizon mundësinë e lejeve të shkurta jonjerëzore. Ajo redukton migrantët në fuqi punëtore, e cila mund të përdoret sipas nevojës dhe pastaj mund të hedhet, pa u njohur atyre të drejtat elementare.

Ajo është e rrezikshme, pasi pengon çfarëdo marrëdhënie me Evropën, duke ndërtuar mure përreth Zvicrës me çka dënon vendin me izolim politik e kulturor.

Ajo është e rrezikshme, pasi edhe ka shanse të kalojë.

Ne duhet të angazhohemi kundër kësaj iniciative: Edhe ata që nuk kanë të drejtë vote duhet të bëjnë gjithçka që është në mundësinë e tyre, për të përfituar shokët e shoqet, fëmijët, prindërit e farefis, kolegët e të njohurit për një Zvicër moderne, të hapur dhe solidare dhe për tu radhitur kundër iniciativës në fjalë. Secila votë kundër ksenofobisë e racizmit është e vlefshme, secila votë për të drejtat e migrantëve, për të drejtën e qëndrimit të qëndrueshëm, për bashkëjetesë me familjen e vet. Migrantet e migrantët duhet të luajnë rolin kryesor në këtë betejë.

**Guglielmo Bozzolini**

Drejtor i Fondacionit Ecopop dhe anëtarë i komitetit qendror të Unia-s



Pamje nga manifestimi i sivjetshëm kundër Ecopop-it

News

**Problemi në punë mbetet akut**

Pasojat e katastrofës së Azbestit edhe në Zvicër ende nuk janë tejkaluar. Përdorimi i materialit që nxit kancerin edhe pse që nga viti 1990 është i ndaluar, megjithatë sëmundjet lajmërohen tek 20 deri 50 vjet më pas. Andaj, Unioni i Sindikatave të Zvicrës dhe Unia në një konferencë për media të qeverisë zvicerane ka kërkuar angazhim edhe më të madh dhe kanë propozuar ndërmarrjen e masave të ndryshme. Pos kësaj kanë kërkuar thirrjen e një tryeze të rumbullakët.

**Kushte më të mira pune për personelin e përkujdesjes**



Rreth 200 të punësuar nga sektori i përkujdesjes dhe mbështetjes private kanë protestuar më 20 shtator në pjesën e qytetit të vjetër të Winterthurit. Ky sektor që, ka vite që vuan jo vetëm nga pagat e ulëta, por edhe turneve të gjata pune dhe mungesë personeli, i bënë të punësuarit të pashpresë. Tani më punonjësit e këtij sektori nuk durojnë këtë gjendje dhe kërkojnë përmirësime të gjendjes shumë të rëndë.

**Dënimet duhet të godasin punëdhënësit**



Sindikatat e transportueseve Unia dhe Syndicom i thonë mjaft jo efikasitetit të zbatimit të rregullores mbi Orarin e punës dhe pauzat të vozitësve profesionistë (ARV 1). ARV duhet të garantoj respektimin e kohës së pauzave (pushimeve) dhe i kontribuon sigurisë së pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor. Megjithatë gjatë kontrolleve zbulohen shkelje të ndryshme të Rregullores në fjalë. Kështu thotë për të përditshmen «Aargauer Zeitung» një ekspert i kontrolleve, i cili në javë bënë vlerësimin e mbi 3000 karta vozitjeje në javë, e nga to me këtë rast del se vetëm 5% të jenë «të pastra». Të dy sindikatat kërkojnë një rregullore, sipas të cilës duhet të obligohet punëdhënësi.

**Ndërtimtaria kryesore, vjeshtë pagash**

**Shefi i punëdhënësve Messmer provokon punëtorët e ndërtimtarisë**

Çdo vjeshtë zhvillohen bisedimet për pagan për të gjithë sektorët – kështu edhe në sektorin kryesor të ndërtimtarisë. Mirëpo në vend të një oferte delegacioni i sindikatave Unia e Syna morën një flakësh – kryetari i shoqatës së ndërmarrjeve ndërtimore Messmer ndërpreu bisedimet. Unia kërkon nga ai të kthehet në tavolinën e bisedimeve, pasi punëtorët e ndërtimtarisë e kanë merituar ngritjen e pagave.

Ndërmarrësit ndërtimorë pranojnë vetë, se sektori i ndërtimit i shkojnë punët mirë: Librat e mandateve janë përplot, ndërsa personeli gati që nuk mjafton. Edhe pse ka një rënie të lejeve të ndërtimit, megjithatë në të njëjtën kohë rriten shumat e ndërtimeve të planifikuara. Pra, janë duke u realizuar më pak projekte, por të cilat janë më të shtrenjta. Në përgjithësi perspektivat janë të mira, kështu që shoqata e ndërmarrësve ndërtimorë dhe Crédit Suisse për 12 muajt e ardhshëm llogarisin me përfitime të qëndrueshme.

**Rriten stresi dhe presioni!**

Është fakt: Në vitet e fundit gjithmonë e më me pak punëtorë ndërtimtarie është ndërtuar më shumë. Me

këtë rast ata punojnë nën presion të jashtëzakonshëm të terminëve dhe stresi. Kjo është një arsye më shumë për rritjen e numrit të aksidenteve në punë: Mesatarisht në çdo 5 vite për arsye aksidenti vdes nga një punëtor, ndërsa rastet e aksidenteve të rënda në punë mjerisht përsëri është rritur.

**Është rendi për ngritje korrekte pagash**

Situata e mirë në sektorin e ndërtimtarisë pasqyrohet gjithashtu edhe në punës të rëndë e punëtorëve të ndërtimtarisë. Ngritja e pagave nuk është fare proporcionale me ngritjen e fitimeve. Ndërsa punëtorët e ndërtimtarisë duhet të paguajnë edhe më shumë për premitë e arkave të shëndetësisë dhe më shumë për qira banimi. Një ngritje



Punëtorët gjatë aksionit kreativ



Kërkojnë 150 franga në muaj



Pamje nga aksionet nëpër kantiere të ndryshme në prag të bisedimeve

pagash prej 150 frangave në muaj si kërkesë nuk është fare e tepruar.

**Ndërmarrësit e ndërtimit nuk duan bisedime**

Megjithatë shoqata e ndërmarrësve të ndërtimit ndërpreu bisedimet në tetor më arsyetime të paqëndrueshme. Kryetari i ndërmarrësve ndërtimor Werner Messmer deklaroi si në vijim: «Përkritazi me pagat nevojitet një pauzë për të menduar» dhe «Sot nuk do të bisedojmë». Me fjalë tjera: Shoqata e ndërmarrësve ndërtimor nuk do të bisedojë me punëtorët e ndërtimtarisë mbi ngritjen e pagave. Unia dhe Syna kanë kërkuar nga shoqata e ndërmarrësve ndërtimor që ti kthehet bisedimeve. Pasi Kontrata Vendore e Punës (LMV) obligon partnerët e bisedimeve të zhvillojnë për çdo vit bisedime mbi pagat.

**Arsyetim i rremë**

Ndërmarrësit ndërtimor arsyetojnë ndërprerjen e bisedimeve ndër të tjera me atë se, Unia e regjionit Cyrih-Shafhausen gjatë realizimit të analizave të ashtuquajtura të rrezikimit përdorë

informata e besueshme të komisionit të paritetit. Këto analiza hetojnë se a mohojnë nën-ndërmarrjet dumpin-gun në paga. Ideja nuk është e re dhe është kërkuar bashkëpunim me shoqatën e ndërmarrësve ndërtimor, mirëpo këta nuk kanë treguar interes. Unia Cyrih-Shafhausen realizon me mandat të ndërmarrjes së përgjithshme Allreal këso analizash. Informatat nga komisioni i paritetit mund të tërhiqen vetëm me pajtimin e ndërmarrjes në fjalë. Ndërmarrjet ndërtimorë pra kërkojnë sipas të gjitha gjasave vetëm një shkas për të mos realizuar bisedimet për paga.

**Aksione nëpër kantiere**

Qysh para bisedimeve për paga punëtorët e ndërtimtarisë kanë kërkuar një ngritje korrekte të pagave prej 150 frangave në muaj. Duke pasur parasysh kundërshtimin e ndërmarrësve ndërtimor për të realizuar bisedimet, aksionet nëpër kantiere do të vijojnë. Punëtorët e ndërtimtarisë do të luftojnë për ngritje korrekte pagash. Ata e meritojnë!

Aurora García

**Të drejtat sindikaliste, e drejta e qasjes**

**E drejta e qasjes së sindikatave**



Punëtorët kanë të drejtë të informohen mbi të drejtat e tyre nga sindikatat

**Ndodhë përsëri e përsëri: Sindikalistët paditën për dhunimin e qetësisë shtëpiake, pasi që me punëmarrësit bisedojnë në vendet e tyre të punës. Me këtë rast situata ligjor është e qartë – dhe pos kësaj edhe gjyqi i qarkut të Cyrihut i ka dhënë të drejtë Unia-s.**

Gjyqi i qarkut të Bulach-ut shtatorin që shkoi ka shpall të pafajshëm pesë sindikalistë të Unia-s, të cilët kanë qenë të paditur për dhunim të qetësisë shtëpiake. Ata kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për qasje në kantiere, për ti informuar punëtorët mbi të drejtat e tyre. Në një kantier u mundësua edhe zbulimi i një rasti të rëndë të dumpingut në paga.

**Më shumë padi**

Në katër raste paditës dhe punëdhënës privat kanë provuar që përmes padive dhe ndalesave shtëpiake të pengojnë punën sindikaliste. Kështu ata duan të pengojnë që sindikalistët të vijnë kontakt të drejtpërdrejtë me punëtorët dhe ti informojnë ata mbi të drejtat e tyre dhe keqtrajtimet e parregullsitë e mundshme.

**E drejtë e garantuar me kushtetutë**

Qasja e lirë është parakusht për një punë efektive sindikaliste. Vlerësimet dhe mendimet ligjore janë të qarta: E drejta e qasjes është një e drejtë e garantuar me kushtetutë. Pasi që liria e ankoruar në të e koalicionit për-

cakton që për të mbrojtur interesat e tyre punëmarrësit guxojnë lirshëm të bashkohen në një shoqatë. Këtu përfshihet edhe e drejta e sindikatave për të shkuar tek të punësuarit.

**Punëmarrësit kanë të drejtë në informacion**

Edhe e drejta e punës u garanton sindikalistëve të drejtën për të shkuar në ndërmarrje, për ti informuar punëmarrësit. Për të shpërndarë afishe e fletëpalosje nëpër parkingjet e firmave, vendosjen e broshurave nëpër hapësirat ku bëhen pauzat, çuarja e njoftimeve dhe vendosja e tyre dukshëm, apo nëse është fjala për një bisedë personale në oborrin e hapësirat e firmës, punëmarrësi nuk ka të drejtë të caktojë ndalesa shtëpiake apo të ngre padi penale zyrtare për dhunim të qetësisë shtëpiake. Kjo përderisa sindikalistët me prezencën e tyre nuk pengojnë në mënyrë të panevojshme procesin e punës. Andaj vendimi i gjyqit të qarkut në Bulach është një shenjë e rëndësishme dhe fuqizon të drejtën e qasjes së sindikatave!

Aurora García

Ligji i të huajve dhe e drejta për përfitime nga sigurime shoqërore

# Shkrim ekspertësh për rastin ekzemplar të Flurim Thaqi

**Si rrezikon praktika e lejeve të qëndrimit në ligjin për të huajt të drejtën e përfitimit nga pensioni i invaliditetit për shqiptarët e Kosovës, ose si përfaqon ligji për të huajt praktikën e diskutueshme të vlerësimeve të Sigurimit të Invaliditetit (IV/AI) mbi dhimbjet.**

Flurim Thaqi, baba i tre fëmijëve, më 19 maj 2006 ka pësuar një aksident pune, kur ai gjatë punës së tij është rrëzuar nga lartësia 3 metrash e skelave dhe me këtë rast pësoi thyerje sakrale të shtyllës kurrizore. Si pasojë e këtij aksidenti në punë filloi një histori vuajtjesh e gjatë dhe dhimbshme shëndetësore dhe juridike, e cila zgjat deri në ditët e sotme dhe në mënyrë ekzemplare përshkruan, se si migrantët nga Kosova mund të humbin të drejtën për përfitime nga sigurimet shoqërore. Pas rastit të rrëzimit Flurim Thaqi nga shtatori 2006 është vlerësuar si i aftë për punë dhe ka vijuar punën e tij përsëri si izolues fasadash në ndërtime.

Në fillim të vitit 2007 atij i janë lajmëruar dhimbjet të forta; Mjeku i tij shtëpiak Flurim Thaqin e ka vlerësuar 100% të paaftë për punë duke i dhënë edhe vërtetimin përkatës me shkrim. Në pamjen e rëntgenit mund të vërehet ngushtimi i boshtit kurrizor (Spinalstenose/stenozë kurrizore L3/4), me dhimbje kurrizore e me zgjerim rrezatues të dhimbjes së këmbëve. Në nëntor 2007n Flurim Thaqit i duhet të operoj kurrizin, me një përmirësim të vogël. Si pasojë e kësaj Flurim Thaqi është i detyruar të përdorë medikamente kundër dhimbjeve dhe barna kundër depresionit.

## Nga aksidenti në punë deri tek humbja e lejes së qëndrimit

Më 15.4.2008 ai lajmërohet tek Sigurimi i Pensionit të Invaliditetit (IV/AI) për tërheqjen e përfitimeve të ligjshme. Sigurimi në fjalë (IV/AI) pas marrjes së vlerësimit të MEDAS

refuzon të drejtën e përfitimeve të ligjshme; Flurim Thaqi sipas vlerësimit në fjalë ishte në gjendje aftësie të 100% të punonte si izolues fasadash!

Më 6.1.2012 Flurim Thaqi pësoi një sulm në zemër dhe me këtë rast aftësia e tij kontribuuese reduktohet edhe më tej.

Për shkak të përkeqësimeve shëndetësore Flurim Thaqi shtron një kërkesë të radhës në adresë të Sigurimit të Pensionit të Invaliditetit (IV/AI), të cilën kërkesë Sigurimi në fjalë (IV/AI) tek pas intervenimit të avokatit e morri në konsideratë dhe është duke e shqyrtuar.

Më 4 korrik 2011 lejes së tij vjetore të qëndrimit B i kalon afati; refuzohet zgjatja e leje së qëndrimit B dhe nga i siguruari kërkohet që të lëshojë Zvicerën deri më 31 tetor 2012 dhe këtë përderisa ishte duke u zhvilluar procedura e pensionit të invaliditetit, me ç'rast intervenon përsëri avokati dhe i cili e bëri të vlefshme se Flurim Thaqi tani për tani nuk mund të udhëtojë për në Kosovë, pasi kështu ai do të humbte të drejtën e përfitimit nga pensioni i invaliditetit.

## Humbja e lejes së qëndrimit pa asnjë faj dhe rrezikimi i pensionit të invaliditetit

Në të vërtetë që nga 1 prilli 2010 nuk ka më Marrëveshje për Sigurimet Shoqërore me Kosovën, dhe si pasojë e kësaj, nuk paguhen më tej pensionet e reja nga kjo datë në Kosovë. Kështu ka vendosur qeveria federale me arsyetime vështirë të besueshme, gjoja për shkak të shpeshimit të rasteve të keqpërdorimeve në Kosovë. Kjo ka si pasojë që personat nga Kosova me rastin



Flurim Thaqi gjatë seminarit për aktivistët sindikalist

e shtrimit të kërkesës për pension edhe në rast të fitimit të së drejtës pas 1 prillit 2010 ju duhet të mbeten në Zvicër për të përfituar nga e drejta e pensionit.

Enti për migracion për shkak të procedurës së hapur ka toleruar prezencën e Flurim Thaqit në Kanton të Schaffhausen-it, mirëpo pa ia zgjatuar atij lejen e qëndrimit.

Vlerësimi i ri kërkuar nga MEDAS nga ana e sigurimit të pensionit të invaliditetit (IV/AI) i vërteton atij paaftësinë e 100%-të për punë të rënda dhe mesatare, megjithatë aftësi të plotë për punë të lehta, çka e ka shtyrë sigurimin (IV/AI) në fjalë të refuzoj kërkesën për pension invaliditeti me një njohje prej 10% shkallë invaliditeti. Me këtë rast problematika shumëvjeçare e dhimbjeve nuk është marr në konsideratë nga ana e sigurimit të pensionit të invaliditetit dhe pjesa tjetër që e bënë çështjen më të vështirë edhe shkaku i problematikës së migracionit.

Kundër këtij vendimi Flurim Thaqi ka bërë ankesë në Gjyqin e lartë; Vendimi është në pritje.

## Emergjencë përkundër procedurës së pensionit të invaliditetit

Sikur të mos mjaftonte me kaq: Flurim Thaqi, pa të ardhura dhe pa mbështetje nga Enti Social i Kantonit Schaffhausen, i ka hequr edhe ndihmën sociale nga 1 prilli 2014; ai është vendosë në emergjencë (ndihmë nën minimale); për të paguhen 520.- franga për qira të dhomës dhe në javë i open vetëm 40 franga në formë kuponësh Migrosi. Enti Social e arsyeton këtë veprim me pritjen se emergjenca shërben për ta motivuar atë që të lëshoj Zvicrën.

Kundër këtij vendimi të Entit Social është apeluar dhe është bërë me dije, se Flurim Thaqi duhet të qëndroj në Zvicër deri sa të sqarohet çështja e pensionit të tij të invaliditetit, përndryshe humb të drejtën e pensionit në fjalë. Ai nuk mund të fajësohet që Zvicra nga 1 prilli 2010 nuk zbaton Marrëveshje për Sigurimet Shoqërore me Kosovën; nisur nga ky fakt ai nuk duhet të motivohet për të lëshuar vendin, pasi me rastin e largimit nga Zvicra ai i humb të

gjitha të drejtat e tij. Edhe këtu është ushtruar ankesa dhe pritet vendimi i Gjyqit të lartë.

## Të ngazëlyer për vendimin e Gjyqit të lartë

Historia e Flurim Thaqit tregon në mënyrë ekzemplare se sa e vështirë mund të jetë për migrantët realizimi i të drejtave të tyre. Sikur të mos mjafton që sigurimi i invaliditetit nuk donë të merre parasysh dhimbjet dhe posaçërisht tek migrantët pretendon se dhimbjet kanë përcaktime kulturore. Kur pos kësaj shuhet edhe leja e qëndrimit dhe gjatë procedurës së shqyrtimit të pensionit të invaliditetit njeriu vendoset në ndihmë të ashtuquajtur emergjente, për t'ia humbur atij të drejtën e pensionit duke e detyruar të kthehet në Kosovë, atëherë kjo përzjerje e së drejtës të huajve dhe asaj të sigurimeve shoqërore paraqet; shkelje kundër parimeve të procedurës korrekte; shkelje kundër ndalimit të diskriminimit dhe shkelje të së drejtës ndërkombëtare për të realizuar për punëmarrësit një siguri sociale. Presim të ngazëlyer se si do të vendosë Gjyqi i lartë i Schaffhausen-it në rastin e Flurim Thaqit.

David Husmann, Avokat specialist, ndër tjera i ligjit të sigurimeve (SAV)



Avokati i mirënjohur David Husmann

Zgjedhjet federale, më 30 nëntor

# JO tatimit paushall

**Iniciativa popullore «Mjaft me privilegjet tatimore për milionerët» kërkon anulimin e tatimit të padrejtë gjithëpërfshirës për miliarderët dhe milionerët e huaj. Ky trajtim i veçantë i për të pasurit si i padrejtë që është duhet anuluar! Më 30 nëntor 2014 do të votohet për këtë iniciativë dhe vien për të votuar për te.**

Mbi 5500 super të pasur të huaj përfitojnë nga i ashtuquajtur tatimi paushall. Kjo d.m.th. se në Zvicër ata nuk duhet të paguajnë tatimin për të ardhurat e tyre efektive si dhe pasurinë e tyre, por vetëm të paguajnë një shumë paushall (gjitëpërfshirëse). Shumica e këtyre pasanikëve e kanë vendbanimin e tyre në Zvicër, për të mos paguar tatim në vendet e tyre amë. Zyrtarisht këta përfitues nuk guxojnë të kryejnë veprimtari fitimprurëse. Mirëpo në realitet fjala është për shumë zonja dhe zotërinjtë ndërmarrës/e, të cilët nga Zvicra i menaxhojnë firmat e tyre ndërkombëtare. Shembulli bie themeluesi i IKEA Ingvar Kamprad apo Viktor Vekselberg i cili është pjesëmarrës në

SULZER dhe OC Oerlikon, u takojnë të pasurve në fjalë që përfitojnë nga tatimi paushall.

## Fund me evazionin fiskal

Falë tatimit paushall disa multimilioner e miliarder të huaj nuk janë të obliguar të deklarojnë raportet e tyre të të ardhurave dhe të pasurisë. Kështu tatimi paushall cytë evazionin fiskal (fshehjen e pagim-tatimit) të tatimoreve paushall të huaj në vendet e tyre amë. Kjo nuk e dëmton vetëm imazhin e Zvicrës, por dëmton posaçërisht vendet gjegjëse amë, të cilat kanë më pak të ardhura tatimore. Kësaj përfundimisht duhet dhënë fund!

## Politik e padrejtë tatimore

Nuk është e vështirë për ta kuptuar, përse vetëm të pasurit mund të paguajnë më pak tatim. Bazuar në kushtetutën zvicerane përcaktimi i tatimit duhet bërë sipas aftësisë e performancës ekonomike. Kjo d.m.th. kush fiton shumë, duhet proporcionalisht

më shumë edhe të kontribuoj për bashkësinë., pra të paguaj më shumë, se sa dikush, që fiton më pak. Në vend se në bazë të të ardhurave dhe të pasurisë këta milioner paguajnë tatim në mënyrë paushall. Si shkallë përcaktuese e tatimit të tyre paushall janë shpenzimet e tyre të supozua-

ra të jetesës. Konkretisht ata duhet të tatimojnë si të ardhura vetëm një shumë paushall – sipas rregullit vlerën e pesëfishit të qirasë së tyre banesore. Pasuria e tyre milionëshe dhe të ardhurat e tyre me miliona mbesin të pa tatimuar.


## Tashmë është hequr në shumë Kantone

Këtë trajtim të veçantë e të padrejtë të super-pasanikëve të huaj e kundërshtojnë partitë e majta dhe sindikatat përmes iniciativës së tyre. Secili duhet të paguaj tatim në bazë të performancës së tij ekonomike dhe të ardhurave të tij. Tatimi paushall nuk duhet të jetë edhe matej i mundshëm. Kantone të ndryshme (ZH, SG, AR, BL, BS) në kohë të fundit kanë anuluar këtë privilegj. Është koha e fundit që këtyre tu bashkohet edhe tërë vendi. Andaj ne me 30 nëntor duhet të votojmë JO dhe të anulojmë tatimin paushall të padrejtë!

Aurora Garcia



Intervista



Pamje nga jeta e rëndë e sezonierëve në barakat e Zvicrës

Manifestim ditor dhe ekspozita

# Si jetonin sezonierët në Zvicër?!

**Më 7 nëntor Unia organizon një seminar ditor dhe një ekspozitë, e cila duhet të na e kujtojë statusin e sezonierëve. Këtë status dëshiron të fusë përsëri Partia Popullore e Zvicrës (SVP) pas votimit të iniciativës të përjashtimit detyrues më 9 shkurt. Çka i pret vizitorët? Për këtë ne kemi pyetur Marilia Mendes: ajo është përgjegjëse për anëtarët që flasin gjuhën portugeze dhe punon në projektin mbi sezonierët.**

Ne na pret një barakë. Jo një e vërtetë, por një ndërtuar tani e në dukje përafërsisht si ato asokohe. Ose më mirë me thënë: Është fjala për një dhomë me shtretër dhe elemente tjera. Brenda saj vizitorët do të kenë rastin të shohin dhe të krijojnë ndjenjën se si kanë jetuar asokohe sezonierët. Ne restaurojmë atmosferën e barakës si pamje kuptimplote për jetën e vështirë dhe të drejtat e kufizuara të sezonierëve.

**Dhe si ia keni arritur rekonstruktimit të atmosferën e atëhershme?**

Ne kemi shikuar shumë filma edhe dokumentar nga ajo kohë, d.m.th. Filma nga vitet e 60-ta deri në ato të 90-ta. Është e pabesueshme, se sa filma dhe materiale fotografike kemi për temën në fjalë. Edhe organizatat pararendëse të Unia-s posedojnë foto material të mjaftueshëm: p.sh. Në vitin 1984 kemi një mori gazetash të GBI-së mbi barakat e sezonierëve. Seria quhet «Barakat e turpshme të javës». Në ndërlidhje me këtë si dhe me iniciativën – bashkërisht, e cila kërkonte anulimin e statusit të sezonierëve, janë bërë vetëdijshëm shumë fotografi. Disa nga këto pamje do ti tregojmë në ekspozitën e fotografive, e cila shoqëron barakën

**A duken në to, edhe nga vijnë njerëz që janë aty?**

Pjesërisht. Duken p.sh. Italianet e veshur mirë, si janë parë ata pjesërisht nga popullata. Mirëpo ne duam parasë gjithash të tregojmë se njerëzit përgjithësisht vinin nga Evropa jugore, d.m.th. Nga Portugalia, Spanja, ish-Jugosllavia. Të gjithë kanë bërë përvoja të ngjashme.

**Çka të ka lënë më së shumti përshtypje gjatë hulumtimit tematik?**

Sa gra kanë ardhur për të punuar në kushte të ngjashme në Zvicër! Kur ne flasim për sezonierët, mendojmë parasë gjithash në burra, të cilët erdhën me çantat e tyre, punuan këtu dhe banuan në barakat e tyre. Në filmat

dhe dokumentarët shihen shumë pak gra, edhe pse kanë ardhur përafërsisht aq shumë sa edhe burra. Kishte vite që erdhën më shumë gra se sa burra. Edhe ato kanë bërë të njëjtat përvoja, u duhej ti nënshtroheshin hulumtimit sanitar kufitar, të lenin burrin dhe fëmijët pas veti në vendin amë. Mirëpo kjo është shumë më pak prezent në vetëdijen tonë.

**Ku kanë punuar atëherë këto gra?**

Në industri, në fabrikat e cigareve, të çokolllatave, të tekstilit, dhe atyre të artikujeve ushqimorë. Nga sindikata VTHL kemi foto të grave nëpër fabrika. Mirëpo, nuk shihet gati asnjëherë se si kanë banuar ato. Kjo duket të jetë një kapitull i harruar i historisë së imigrimit.

**Kjo është historia e së kaluarës, por edhe në ditët e sotme ka ende punëtorë, të cilët jetojnë në kushte të këqija.**

Po, ne e tematizojmë edhe këtë fakt. Në seminarin ditor, në ekspozitë dhe edhe në publikim, të cilin ne do ta bëjmë për temën. Ne tregojmë fjala bie fotografi, ku duket, se si jetojnë edhe tani njerëzit, të cilët vijnë për të punuar në Zvicër. Fjala është për punëtorët temporal, të cilët vijnë të punojnë për pak muaj dhe të cilët nuk kanë as kohë e as parat ë mjaftueshme për të kërkuar një banesë të dinjitetshme dhe për të njohur të drejtat e tyre. Qëllimi ynë është për ti vu në qendër të vëmendjes këto situata: Për te kujtuar të kaluarën, për të tërhequr vëmendjen për atë se çka d.m.th. me ardhur me qëndrim të kufizuar në Zvicër. Edhe me Marrëveshjen për qarkullim të lirë të personave, për migrantët nuk janë zhdukur tërësisht kufizimet përkitazi me lejet e qëndrimit dhe kushtet e këqija të punës e banimit. Dhe pas zbatimit të marrëveshjes së iniciativës për ndalimin e migrimit masiv do të shtohen këto situata jonjerëzore edhe më tej. Ne si sindikatë duam të luftojmë kundër kësaj, ashtu sikur kanë luftuar sindikatat para nesh.

Anna Luisa Ferro Mäder, area sindacale



Pamje nga protesta e sezonierëve të ish-Jugosllavisë

Datat e ekspozitës

**«Barakat, ksenofobia dhe fëmijët e fshehur: Kështu jetonin sezonierët në Zvicër»**

Bernë, Waisenhausplatz, 7. – 13. nëntor 2014

Gjenevë, allée centrale de la Plaine de Plainpalais, 17. – 23. nëntor 2014

Më shumë informata nën: <http://www.unia.ch/de/aktuell/events/detail/a/10170/>

Porositja falas për publikimin: «Barakat, ksenofobia dhe fëmijët e fshehur – Andaj nuk guxon të ketë status sezonierësh në Zvicër» (gjermanisht, frëngjisht ose italisht): [migration@unia.ch](mailto:migration@unia.ch).

# Ju pyesni, Unia përgjigjet



**Zbritjet nga paga:**

**Si mund ta di nëse shefi i ka përcjellë ato më tej?**

**Ka kohë që punëdhënësi im financiarisht nuk i ka punët mirë. Pagat deri më tani i kemi marrë rregullisht. Edhe zbritjet për sigurimet shoqërore janë të shënuara në llogarinë e pagës. Në të vërtetë tani kam dëgjuar thashetheme se shefi im nuk i dërguar më tej zbritjet nga paga për fondin e kompensimit. A ka mundësi unë ta kontrolloj disi këtë.**

Po ju mund ta bënë këtë. Për tu siguruar a i ka llogaritur zbritjet e kontributeve tek fondi i kompensimit dhe se a është periudha e kontributeve tuaja pa zbrazëti, nga fondi i kompensimit mund të kërkoni një pasqyrë bankare (financiare), një të ashtuquajtur raport individual të kontos, i cili do të lëshohet për konton e juaj individuale. Këto raporte mund ti porositni përmes postës me shkrim apo edhe përmes internetit në (<http://goo.gl/HglJmb>). Nëse punëdhënësi juaj nuk i ka kryer obligimet ligjore, për ju kjo nuk ka ndonjë pasojë, pasi kontributet, të cilat firma i ka zbritur nga paga juaj, do të barten në konton e juaj individuale. Kjo edhe atëherë, kur ajo kontributet në fjalë nuk i ka transferuar. Mirëpo ju duhet – përmes listave tuaja të pagës – të dëshmoni pa mëdyshje që juve u janë bërë zbritjet e kontributeve në fjalë. Zbritjet duhet të jenë të shënuara në listat e pagës. Nëse këtë nuk mund ta dëshmoni, atëherë ato nuk mund të regjistrohen në konton tuaj individuale. Kështu krijohet një zbrazëti sigurimi.

Alice Maridor, work, 4.9.2014

**Pushimet e rezervuara:**

**A mund të nisem për rrugë?**

**Unë qe katër muaj jam i papunë. Qysh në fillim të vitit kam rezervuar një javë pushim për në mes të muajit nëntor në Itali. A guxoj unë fare të shkojë në pushime. Dhe nëse po: A do të marrë në këtë kohë kompensimin nga arka e sigurimit të papunësisë?**

Po, ju guxoni të bëni pushim dhe gjatë pushimit merrni edhe më tej kompensimin nga arka e sigurimit të papunësisë, të ashtuquajturat para ditore. Në parim tek sigurimi i papunësisë parashihet rregullimi i pushimeve si në vijim: Pas 60 parave ditore të papunët së pari marrin 5 ditë pushime. Nisur nga kjo gjithmonë pas 60 parave ditore i takojnë 5 ditë pushimi. Pasi tani ka katër muaj se jeni i papunë keni pas jush këto 60 ditë papunësi dhe mund të shkoni për një javë në pushime. Mirëpo keni parasysh pikat vijuese:

1. Ditët e pushimit nuk mund ti tërhiqni para kohe
2. Ju duhet t'ia komunikoni pushimin tuaj më së voni 14 ditë më para entit regional për ndërmjetësim të punës
3. Ditët e pushimit mund ti merrni vetëm si javore
4. Ditët e pushimit të rezervuara të pushimit, nëse përsëri keni një vend pune, nuk do t'ju paguhet. E drejta juaj për pagat ditore nuk zgjatet përmes kësaj.

Ditët e pushimit me rastin e papunësisë në fjalorin profesional emërohen «parat ditore të pakontrolluara»: Më këtë mendohet se ju jeni të liruar nga çdo obligim karshi sigurimit të papunësisë (p.sh. nga aplikimi me shkrim për punë), pro megjithatë i merrni paratë. Në përlogaritjen mujore të arkës së papunësisë mund të shihni gjithmonë, sa këso para ditore të pakontrolluara ju takojnë.

Timur Öztürk, work, 18.9.2014

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariasián, M. Martín, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.